

VENDIM
Nr. 163, datë 28.12.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “HEC TERVOLI” SHPK, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI
KOLATERAL PRANË “RAIFFEISEN BANK”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 6, 7 dhe 8, të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të aseteve të shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k., si kolateral nga pranë “Raiffeisen Bank”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2 (janë paraqitur në mënyrë korrekte).
- Neni 7, pika 1.3, germa “b”, “e” (janë paraqitur në mënyrë korrekte).
- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me: nenin 7, pika 1.3, gerrat “a”, “c”, “d”, “f”, “g”, “h”, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 9 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, t’i paraqesë ato brenda afatit të caktuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të aseteve të shoqërisë pranë “Raiffeisen Bank”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet